Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1 Opinioni i Auditimit

2 Gjetjet dhe rekomandimet

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkojmë falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Faton Peci, Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Adresa: Rr.Ukshin Hoti, Kompleksi Ramiz Sadiku, Prishtinë, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.[1]

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera[2], për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

Për 12 pagesa në vlerë prej 497,577€, të ekzekutuara nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, ne nuk ishim në gjendje të kryejmë procedurat e rregullta të auditimit, për shkak se pagesat ishin në procedurë hetimore nga organet e drejtësisë dhe ne i jemi shmangur interferimit në këto raste. Për këtë arsye, ne nuk jemi në gjendje të ofrojmë siguri për ekzekutimin e tyre në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.

Përveç kësaj:

B1 Pasuria kapitale (me vlerë mbi 1,000€) nuk prezanton vlerën e saktë të pasurive. Auditimi ka nxjerrë në pah se në tetë (8) raste pasuria kapitale mbi 1,000€ ishte e mbivlerësuar për 371,496€ ndërsa ishte nënvlerësuar për dy (2) pagesa në vlerë 153,590€.

A1 Shpalosja e obligimeve të papaguara në fund të vitit 2020 nuk ishte pasqyruar drejt në PFV. Në katër (4) raste në vlerë prej 67,211€, obligimet e papaguara ishin mbivlerësuar. Ndërsa në dy (2) raste në vlerë 143,706€ nuk ishin prezantuar në PVF.

A2 Nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, ishin ekzekutuar dy (2) pagesa në vlerë 153,590€, të cilat për nga natyra i takonin kategorisë së investimeve kapitale.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

A3 Gjatë kryerjes së pagesave, kemi vërejtur që ministria në katër (4) raste në vlerë 318,732€, në fillim kishte pranuar faturën, pastaj kishte bërë zotimin e mjeteve dhe nxjerr e urdhër blerjen.

B2 Në 13 pagesa në vlerë 147,446€ kishte vonesë në pagesa duke filluar nga 12 deri 204 ditë, pas afatit të lejuar prej 30 ditësh. Ndërsa në 20 pagesa për subvencionet e dhëna përmes Programit për Zhvillimin e Bujqësisë (grantet) në vlerë totale 916,431€, pagesat kishin tejkaluar afatet e përcaktuara për pagesë nga 4 deri në 194 ditë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Çështjet kyçe të auditimit

Çështjet kyçe të auditimit në auditimin e Pasqyrave Financiare të MBPZhR për 2020 ishin si më poshtë:

1. Agjencia për Zhvillim të Bujqësisë (AZhB) që në nga viti 2018 ka të formuar Drejtorinë e financave me të gjitha pozitat e nevojshme për të funksionuar si agjenci e pavarur. Pavarësisht kësaj, ekzekutimi i pagesave ende vazhdon të bëhet nga zyra qendrore e financave në ministri. Menaxhmenti i lartë i ministrisë dhe AZhB nuk kishin ndërmarr veprime të mjaftueshme për të bërë të mundur funksionalizimin e këtyre strukturave brenda AZhB-së. Kjo ka shkaktuar vonesa në pagesa dhe punë shtesë administrative për AZhB dhe ngecje në procesin e zhvillimit të bujqësisë dhe si pasojë, mos përfitimit të fondeve nga Komisioni Evropian.

2. Vlera e obligimeve të papaguara ndaj fermerëve në fund të vitit 2020 ishte 40,396,909€. Prej tyre, për Pagesat Direkte sipas programit të rregullt vjetor të ministrisë ishin 13,486,360€, obligimet si rezultat i Programit për Rimëkëmbjen Ekonomike në Bujqësi 18,916,340€ si dhe detyrime prej 7,994,209€ të cilat u janë aprovuar fermerëve sipas programit vjetor për zhvillimin e bujqësisë (granteve).

   Rritja e obligimeve ishte si rezultat i mungesës së mjeteve financiare si dhe menaxhimit jo të mirë në fushën e subvencioneve. Kjo si rezultat i vonesave në aprovimin e programit, përkrahjes financiare të fermerëve sipas Programit të rregullt për pagesat direkte dhe programit për Rimëkëmbje Ekonomike përtej buxhetit të aprovuar nga Qeveria si dhe kryerja e obligimeve të bartura nga viti paraprak.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.[3]

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve (shih Grafikun 1). Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike[4]



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Parregullsi në regjistrimin dhe raportimin e pasurive

Gjetja

Rregullorja MF Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Organizatave Buxhetore, te neni 6, citon që: çdo organizatë buxhetore duhet të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që ka në menaxhimin e saj. Më tej, pika 3 përcakton se regjistri i pasurive duhet të përfshijë pasuritë kapitale mbi 1,000€ që duhet të regjistrohen në SIMFK, ndërsa pasuritë jo kapitale nën 1,000€ dhe stoqet në E-pasuri. Po ashtu sipas UA 04/2019 Neni 8 dhe shtojcës 1 të po të njëjtit udhëzim, përcakton se: shpenzimet në fazën e identifikimit të projektit si, shpenzimet për paga dhe përfitimet e tjera për ekipin e projektit, shpenzimet e konsulentëve, shpenzimet e udhëtimit për ekipin e projektit klasifikohen si shpenzime rrjedhëse.

Gjatë testimit të pasurive kemi vërejtur dobësitë si në vijim:

- Regjistri i pasuria kapitale me vlerë mbi 1,000€ nuk prezanton vlerën e saktë të pasurive në ministri. Në 5 raste pasuria kapitale mbi 1,000€ ishte e mbivlerësuar për 314,404€. Kjo kishte ndodhur për shkak se Ministria kishte përfshirë në regjistrat e saj pasurinë e cila sipas marrëveshjes mes Bankës Botërore dhe MBPZHR-së në kuadër të projektit “Rehabilitimi dhe Modernizimi në Sistemin e Ujitjes në kompaninë rajonale të ujitjes Radoniqi dhe Dukagjini" kalojnë direkt në pronësi të KUR Radoniqi”;
- Në tri (3) pagesa të realizuara për blerjen e Softuerit, pasuria ishte e mbivlerësuar në vlerë prej 57,092€, për faktin që pagesat kishin të bënin me shpenzimet e Ekspertëve të TI-së, trajnimin e stafit si dhe vizitat studimore;
- Në dy (2) pagesa në vlerë 153,590€ për zhvillimin e Sistemit GIS Desktop në kontratën "Konsolidimi dhe Inventarizimi i tokave Bujqësore në Republikën e Kosovës", nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive;
- Po ashtu, 11 prona tokësore të Institutit Bujqësor të Kosovës (IBK), ende nuk kontrollohen dhe shfrytëzohen nga IBK, por të njëjtat shfrytëzohen nga individët privat. Kjo e gjetur vazhdon të përsëritet ndër vite në raportet e auditimit dhe se sipas IBK-së është mungesa e rregullimit të kornizës ligjore për organizimin e Institutit Bujqësor të Kosovës.

Kjo kishte ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrollit të brendshme dhe mungesës së përgjegjësisë në kryerjen e detyrave nga zyrtarët kompetent.

Ndikimi

Regjistrimi i pasurisë të cilat nuk janë pronë e MBPZHR-së si dhe mos regjistrimi i pasurisë në regjistrat përkatës të pasurive jo financiare ndikon në prezantimin jo të drejt të pasurive në PVF dhe pamundëson një menaxhim dhe kontroll efektiv mbi pasuritë me rrezikun që pasuritë të humbin apo keqpërdoren.

Rekomandimi B1 Ministri duhet të ndërmarrë veprime për të siguruar regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë siç parashihet me Rregulloren Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, në mënyrë që gjendja e pasurisë të raportohet në mënyrë të saktë dhe të drejtë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Shpalosje jo e drejtë e obligimeve të papaguara në PVF

Gjetja Sipas Rregullores Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar - Neni 17, përcakton se organizatat buxhetore duhet të raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) e krijuara deri më 31 dhjetor të vitit raportues.

Gjatë auditimit, ne kemi identifikuar se shpalosja e obligimeve të papaguara të MBPZhR dhe Agjencisë Pyjore të Kosovës (APK) në fund të vitit 2020 nuk ishte pasqyruar drejt në PFV. Kjo për arsyen se në katër (4) raste në vlerë prej 67,211€, obligimet e papaguara ishin mbivlerësuar. Ndërsa në dy (2) raste në vlerë 143,706€ nuk ishin prezantuar fare në PFV.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së informacioneve të duhura gjatë përgatitjes dhe prezantimit të informatave në PFV.

Ndikimi Shpalosja jo e drejtë e obligimeve, ka ndikuar në keqdeklarimin e llogarive të pagueshme, duke reflektuar në prezantimin jo të drejt të informatave për shfrytëzuesit e PFV-ve.

Rekomandimi A1 Ministri duhet të sigurojë që me rastin e përgatitjes së PFV zbatohen procedurat adekuate të kontrollit të brendshëm duke verifikuar saktësinë dhe plotësinë e të dhënave për obligimet e papaguara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare Nr. 01/2013 Shpenzimi i Parave Publike, përcakton që, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël.

Gjatë testimit të shpenzimeve, nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve kemi vërejtur që ishin ekzekutuar dy (2) pagesa për shërbime kontraktuese tjera "Konsolidimi dhe Inventarizimi i tokave Bujqësore në Republikën e Kosovës" në vlerë 153,590€ e cila për nga natyra i takonte kategorisë së investimeve kapitale. Kjo meqenëse pagesa kishte të bënte me blerjen dhe instalimin e sistemit GIS, program i cili bënte të mundur funksionimin e Sistemit të Informacionit Gjeografik Kombëtar.

Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve ka ndodhur si rezultat i planifikimit jo të mirë të shpenzimeve dhe mungesës së kontrolleve të brendshme.

Ndikimi Pagesat e kryera nga kodet jo adekuate të shpenzimeve ndikojnë në nënvlerësimin e kapitaleve dhe mbivlerësimin e mallrave dhe shërbimeve, që për efekt kanë paraqitjen e pa saktë të gjendjes së llogarive.

Rekomandimi A2 Ministri duhet të sigurojë planifikimin e buxhetit në përputhje me natyrën e projekteve në mënyrë që pagesat të realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A3 - Mangësi në procedimin e pagesave

Gjetja Rregulla Financiare Nr.01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, neni 22 parasheh që fillimisht duhet të procedohet zotimi i mjeteve, lëshohet urdhër blerja dhe pas pranimit të blerjeve bëhet raporti i pranimit, si dhe pranohet fatura.

Nga 13 mostra të testuara, në katër (4) prej tyre në vlerë prej 318,732€ kemi identifikuar se ministria, në fillim kishte pranuar faturën, pastaj ishte bërë zotimi i mjeteve dhe urdhër blerja.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mos-zbatimit të rregulloreve për shpenzimin e parasë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës dhe situatës së krijuar nga pandemia.

Ndikimi Mos aplikimi i procedurave të duhura të kontrollit gjatë procesit të pagesave, mund të ndikojë që ministria mos t'i kryej obligimet e faturuara me kohë si dhe rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi A3 Ministri duhet të siguroj se respektohen të gjitha procedurat e përcaktuara me rregullore në mënyrë që para procedimit të pagesave, fillimisht të bëhet zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja, të pranohet malli/shërbimi dhe në fund të kryhet pagesa.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Vonesa në pagesën e obligimeve

Gjetja Ligji për Menaxhimin e Financave Publike, neni 39, obligon Ministrinë për pagesën e çdo fature të vlefshme brenda afatit 30 ditësh nga data e pranimit të faturës apo kërkesës për pagim. Ndërsa afatet kohore për kryerjen e pagesave të granteve përcaktohen me udhëzuesit që i nxjerr ministria për zbatimin e programeve vjetore të aprovuara. Në bazë të këtyre udhëzuesve, pagesat duhet të bëhen 20 ditë pas marrjes së vendimit apo 40 ditë nga data e aplikimit për pagesë, përveç nëse tejkalimi i afatit bëhet për ndonjë arsye objektive.

Nga lista e obligimeve të shpalosura në PFV kemi testuar 13 mostra dhe nga testimi ka rezultuar se faturat me vlerë të përbashkët 147,446€, nuk ishin paguar brenda afatit të paraparë ligjor. Vonesat në pagesa janë duke filluar nga 12 deri 204 ditë.

Ndërsa në 20 raste të ekzaminimit të pagesave për subvencionet e dhëna përmes Programit për Zhvillimin e Bujqësisë (grantet) në vlerë totale 916,431€, kemi vërejtur se pagesat kishin tejkaluar afatet e përcaktuara për pagesë. Vonesat në rastet e ekzaminuara ishin nga 4 deri 194 ditë.

Sipas zyrtarëve të ministrisë, kjo ishte si rezultat i mos alokimeve të duhura të buxhetit për shpenzim nga ana e ministrisë së financave dhe punës me staf esencial gjatë periudhës së pandemisë.

Ndikimi

Mos kryerja e obligimeve brenda afatit të paraparë ligjor ndikon në rritjen e detyrimeve të papaguara si dhe në rritjen e mundësisë që Ministria t'i ekspozohet padive gjyqësore dhe të paguaj kosto shtesë. Për më tepër vonesat në pagesa për përfituesit e granteve mund të shkaktojnë probleme serioze për fermerët, për shkak se të njëjtit mund të fillojnë aktivitetet dhe të hyjnë në obligime duke u bazuar në pagesat apo kompensimet që pritet t'ua bëj ministria. Vazhdimi i praktikave të deritanishme mund të dëmtojë rëndë sektorin e bujqësisë, por edhe ministrinë ta sjellin në situata të vështira financiare.

Rekomandimi B2

Ministri duhet që me pjesën tjetër të menaxhmentit, në hollësi ta analizojë gjendjen e detyrimeve të krijuara sipas programeve të ndryshme të subvencionimit dhe të bëj prerjen e gjendjes deri në datën e raportit. Së pari të siguroj se të gjitha grantet, pagesat direkte dhe detyrimet tjera të krijuara më herët, të paguhen, e më pas të krijon obligime të reja ndaj farmerëve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 61,770,545€. Prej tyre në vitin 2020 ishin shpenzuar 61,643,007€. Subvencionet ndërlidhen me zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimin rural që kanë për qëllim zgjerimin dhe përmirësimin e prodhimtarisë së tyre përmes pagesave direkte (subvencioneve) dhe granteve. Politikat dhe buxheti përgatiten nga Autoriteti Menaxhues në bashkëpunim me Ministrin dhe Sekretarin e Përgjithshëm, ndërsa implementimi i politikave bëhet nga AZhB-ja. Ekzekutimi i pagesave bëhet nga zyra e financave në MBPZhR. Në këtë fushë ne kemi testuar 70 mostra për teste substanciale dhe të pajtueshmerisë në vlerë 3,819,089€ dhe 6 mostra për teste për pajtueshmëri me procedurat.

Çështja B3 - Mangësi në hartimin dhe aprovimin e Programit për Pagesa Direkte

Gjetja	Programi për pagesa direkte në bujqësi duhet të ketë të përcaktuara qartë afatet kohore për përgatitjen dhe aprovimin e tij si dhe të ketë të përcaktuara kriteret e mbështetjes financiare në përputhje me ndarjet buxhetore të vitit. Përkundër rekomandimit nga viti i kaluar, ministria edhe këtë vit Programin për Pagesa Direkte e kishte aprovuar në korrik të 2020. Ky fakt ka shkaktuar vonesë në procesin e subvencionimit duke filluar nga thirrja për aplikim, kontrollet në terren e deri te finalizimi i pagesës. Njëkohësisht si rezultat i mos përcaktimit të kritereve të sakta në program, mbështetja financiare për fermerë përmes pagesave direkte tejkalon buxhetin e aprovuar vjetor. Kjo kishte ndodhur për shkak të mos ndërmarrjes së veprimeve të duhura për hartimin dhe miratimin me kohë të programit dhe udhëzimeve administrative për subvencione.
Ndikimi	Vonesat në përgatitjen e programit dhe shpallja e programit në këtë periudhë të vitit, duke pasur parasysh se bujqësia është prodhimtari sezonale dhe se shumica e kulturave në këtë periudhë veç janë në përfundim të ciklit të tyre, kjo rrit rrezikun e aplikimit të fermerëve për të mbjella të cilat mund të mos kenë qenë në përputhje me gjendjen faktike në terren, duke rezultuar me pagesa për sipërfaqe të papunuara dhe vlerë të ulët për para. Për më tepër, obligimet financiare të bartura për pagesë për vitin në vijim, rëndojnë bilancin e obligimeve edhe për ministrinë, edhe për fermerët.
Rekomandimi B3	Ministri duhet të siguroj se programi për subvencione të hartohet dhe miratohet në fillim të vitit fiskal, me qëllim të harmonizimit të tij me ciklin buxhetor, thirrjen për ndarjet vjetore të subvencioneve si dhe ekzekutimin e pagesave brenda vitit, si dhe të përcaktojë kriteret të sakta në program në mënyrë që mbështetja financiare për fermerë të jetë në përputhje me buxhetin e aprovuar vjetor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Mangësi të identifikuara në Subvencione

Gjetja

Sipas UA nr. 03/2020 për Pagesat Direkte në Bujqësi neni 38 përcakton se një nga dokumentet e nevojshme për plotësimin e kushteve administrative për përfitimin e subvencioneve është fleta poseduese nga kadastra për sipërfaqen e tokës së punueshme në pronësi të aplikuesit ose në rast të marrjes me qira kopjen e kontratës që dëshmon disponueshmërinë e tokës bujqësore.

Nga testimet tona ne kemi identifikuar se në gjashtë (6) pagesa me vlerë 61,541€, ministria kishte subvencionuar përfituesit e pagesave direkte edhe pse përfituesit në aplikacionet e tyre kishin ofruar fletat poseduese nga kadastra për sipërfaqe tokash që nuk ishin në pronësi të tyre, por vetëm me mbiemër të njëjtë dhe nuk kishin ofruar ndonjë dokument si dëshmi të afërsisë familjare apo kontratë për marrjen me qira të pronës.

Sipas shpjegimeve të menaxhmentit, kjo ka ndodhur si rezultat i problemeve pronësore në nivel të përgjithshëm të vendit.

Ndikimi

Subvencionimi i përfituesve me fonde publike pa mbështetje të dokumenteve të përcaktuara me UA mund të rezultojë me pagesa potencialisht të parregullta dhe keqpërdorim të subvencioneve.

Rekomandimi A4

Ministri duhet t'i rishikoj rastet e mësipërme dhe të siguroj se financimi i fermerëve bëhet vetëm pasi të jenë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në UA. Kontrollet lidhur me ndarjen e subvencioneve duhet të jenë shumë më rigoroze.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Vlerësim i aplikacionit jo në përputhje me UA për masat dhe kriteret e përkrahjes për Zhvillimin Rural

Gjetja

Sipas UA nr. 16/2019 për masat dhe kriteret e përkrahjes për zhvillim rural kapitulli IV neni 13 pika 3.2.4 përcakton se përfituesit nuk mund t'i jepet një projekt i ri, nëse projekti i mëparshëm nuk është përfunduar në përputhje me kontratën e nënshkruar me Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB).

Ne kemi identifikuar se në një rast, edhe pse përfituesi kishte një projekt tjetër të mëhershëm të financuar nga ministria, të cilin nuk e kishte realizuar sipas kushteve të kontratës dhe se për të ishte në procedura gjyqësore, Ministria kishte nënshkruar marrëveshje të re për financim duke lidhur kontratë në vlerë 399,000€. Prej kësaj kontrate AZHB do të mbështes financiarisht subjektin në vlerë 199,500€ apo 50% të shumës maksimale të investimit të pranueshëm për "Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore".

	Kjo kishte ndodhur për arsyen se Drejtoria e Miratimit të Projekteve për Zhvillimin e Bujqësisë, gjatë procesit të kontrollit administrativ dhe vlerësimit të aplikacionit, nuk kishte pasur informatën zyrtare nga Drejtoritë përkatëse, se aplikuesi është në proceduara gjyqësore apo në listën e zezë për mos përmbushje të kontratës. Megjithatë, Drejtoria e Miratimit menjëherë pas marrjes së informacionit kishte pezulluar zbatimin e projektit deri në marrjen e vendimit nga gjykata, ndërsa pas vendimit të lëshuar nga gjykata në favor të përfituesit, ministria gjegjësisht AZHB, kishte përgatitur vendimin për vazhdimin e zbatimit të projektit.
Ndikimi	Vlerësimi dhe përzgjedhja e përfituesve të subvencioneve në kundërshtim me udhëzimin administrativ rritë rrezikun e favorizimit të fermerëve si dhe ndarjen e paligjshme të fondeve.
Rekomandimi A5	Ministri duhet të siguroj se kriteret e përcaktuara në Udhëzim Administrativ zbatohen me përpikëri nga zyrtarët përgjegjës të AZhB-së, dhe të sigurojë se nuk do të kalojë në procesin e vlerësimit asnjë përfitues i cili nuk i ka përmbushë kushtet e kontratës paraprake.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 43,570,165€, pasurive jokapitale është 104,632€, si dhe e stoqeve 13,478€. Ne kemi testuar 75 mostra për teste substanciale në vlerë 2,227,676€.

Çështja B4 - Mos harmonizimi i Raportit të inventarizimit me regjistra të pasurisë

Gjetja	Sipas Rregullores Nr. 02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 19 paragrafi 4.3, thotë se Përgjegjësi e Komisionit për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare është edhe "Krahasimi i gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare". Në MBPZHR është bërë inventarizimi i pasurisë për vitin 2020. Komisioni kishte përpiluar një raport gjithëpërfshirës, mirëpo nuk ka bërë harmonizimin e gjendjes së inventarizuar me gjendjen kontabël të pasurive jo financiare dhe se raportimi i pasurive në PVF ishte bërë sipas regjistrave kontabël. Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive.
Ndikimi	Për shkak të mos sqarimit të diferencave në mes gjendjes së inventarizimit dhe gjendjes kontabël, nuk është e mundur të konfirmohet ekzistenca e pasurisë dhe gjendja e tyre funksionale.
Rekomandimi B4	Ministri duhet të sigurojë se komisioni i inventarizimit do të bëjë krahasimin e gjendjes së pasurisë sipas raportit të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurisë, të azhurnoj regjistrin me rezultatet e inventarizimit dhe gjendjen e azhurnuar ta prezantoj në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Të arkëtueshmet

Vlera e llogarive të arkëtueshme e prezantuar në PVF 2020 ishte 3,583,280€, prej tyre 3,492,918.30€ apo 97% I përkasin APK-së dhe kanë të bëjnë me obligimin që kanë OE ndaj APK-së për ri-kultivimin e tokave pas shfrytëzimit të tyre. APK ka ndërmarrë të gjitha masat për inkasimin e këtyre llogarive duke përfshirë edhe veprimet ligjore.

Çështja A6 - Ndërrimi i përkohshëm i destinimit të tokës bujqësore

Gjetja	Sipas nenit 30 pika 30.1 të Ligjit Nr 02/L-26 - Toka bujqësore mund t'u ipet me qira personave fizik dhe juridik, vendas dhe të huaj të cilët merren me veprimtari bujqësore. Sipas Nenit 3 të kontratës, pagesa bëhet deri me datën 10-të të çdo muaji vijues. Gjatë testimeve në dy (2) raste kemi vërejtur që qiramarrësit e tokave bujqësore nuk ushtronin veprimtari përkatëse sipas Ligjit, ku në vend të shfrytëzimit për tokë bujqësore kishin shfrytëzuar për qëllime ndërtimi të përkohshme si depo për material ndërtimor dhe për tregtim të karburanteve. Po ashtu nuk ishte aplikuar çmimi në përputhje me çmimet e tregut sipas zonave ku operojnë qiramarrësit. Për më tepër shfrytëzuesit e pronave nuk kishin kryer obligimet sipas kontratës, për vlerën 20,000€. Kjo kishte ndodhur si pasojë e mos respektimit të rregullativës ligjore dhe mos përcaktimit të kritereve të qarta për dhënien e pronës në shfrytëzim sipas çmimeve të tregut.
Ndikimi	Dhënia në shfrytëzim e tokës bujqësore në kundërshtim me kërkesat ligjore, rrezikon ndërrimin e destinimit të tokave bujqësore, si dhe rritë rrezikun e humbjeve financiare si shkak i normave të ulta të çmimit të qirave dhe mos shlyerjes me kohë të detyrimeve të qiramarrësve ndaj ministrisë.
Rekomandimi A6	Ministri duhet të sigurojë që dhënia në shfrytëzimin e tokave bujqësore bëhet në përputhje me kriteret e parapara me ligj, në përputhje me çmimet e tregut, si dhe duhet siguruar që të ndërmerren hapat e nevojshëm lidhur më arkëtimin e të hyrave për dhënien në shfrytëzim të tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në PVF në fund të vitit 2020, ishte 13,486,359€. Përveç kësaj vlere, MBPZhR kishte edhe obligime në vlerë 20,000,000€ për subvencionet e ndara me Vendim të Qeverisë për Programin e Rimëkëmbjes Ekonomike si dhe 7,994,209€ obligime për subvencionet për zhvillimin rural (grante). Arsye e mos shlyerjes se këtyre obligimeve janë, pranimi i faturave me vonesë si dhe mungesa e buxhetit.

Çështja A7 - Hyrja në obligime për pagesat direkte jo në përputhje me buxhetin

Gjetja

Qeveria e Kosovës me vendimin Nr.01/23 të datës 13.08.2020 me qëllim të zbatimit të Programit për Rimëkëmbjen Ekonomike në sektorin e bujqësisë ka ndarë fonde në vlerë 24,000,000€ në mënyrë që të ndikoj në rritjen e prodhimeve bujqësore, rritjen e punësimit në zonat rurale, zvogëlimin e importit të produkteve bujqësore, tejkalimin e sfidave nga mungesa e shitjeve nga COVID 19 dhe rritjen e sigurisë së ushqimit.

Ministria kishte përzgjedhur fermerët të cilat janë vlerësuar si përfitues të rregullt sipas programit vjetor për Pagesat Direkte (subvencionet), për vitin 2020 në vlerë 35,474,240€. Vlen të theksohet, që Ministria nuk përcakton kufizime të aplikuesve për përfitimin e subvencioneve dhe rrjedhimisht shuma e mjeteve të aprovuara prej 24,000,000€ nuk mbulon realizmin e pagesave për të gjithë përfituesit e lartë cekur.

Me qëllim të mbulimit të pagesave për të gjithë përfituesit, pas kërkesës së Ministrit të Bujqësisë, Qeveria në mbledhjen e datës 28.09.2020 me vendim nr. 03/33 miraton dyfishimin e Buxhetit për Programin për Pagesa Direkte (subvencione) për secilën kulturë/masë të paraparë në Programin e Pagesave Direkte për vitin 2020, duke krahasuar me vlerat e vitit 2019.

Mirëpo edhe ky vendim nuk mbulon realizimin e pagesave për të gjithë përfituesit e pagesave Direkte. Kjo meqenëse edhe shpërndarja e subvencioneve për vitin 2020 duke krahasuar me vlerat e vitit 2019 kap totalin prej 30,842,294€, prej të cilave 11,925,954€ ishin paguar në vitin 2020 dhe 11,999,993€ do të paguhen në vitin 2021, e që rrjedhimisht pjesa e mbetur prej 6,916,347€ ka hyrë në obligime pa mbulesë buxhetore.

E gjithë kjo kishte ardhur si rezultat i menaxhimit jo të mirë të financimit e cila ishte bërë pa ndonjë analizë të mirëfilltë se si do të ndikonte subvencionimi në tejkalimin e pasojave të shkaktuara nga COVID 19 në Bujqësi.

Ndikimi

Mungesa e përpjekjeve nga Ministria për të bërë shpërndarjen e mjeteve financiare në përputhje me mjetet e ndara buxhetore, e ka futur ministrinë në obligime financiare dhe vështirësi në arritjen e objektivave vjetore të përcaktuara për vitin pasues.

Rekomandimi A7

Ministri në bashkëpunim me Qeverinë duhet të sigurojnë fondet e nevojshme për kryerjen e obligimeve të krijuara. Po ashtu Ministri duhet të vendosë kontrollet adekuate për të siguruar se çdo vendim për mbështetje financiare do të bëhet në përputhje me buxhetin e aprovuar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.5 Funksioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) në MBPZhR operon me Ushtrues Detyre të Drejtorit të NjAB dhe dy auditorë. Auditimet kryhen sipas planit strategjik dhe vjetor dhe përfshijnë fushat me më shumë ndjeshmëri dhe rrezik. Përveç Planit strategjik, NjAB kishte hartuar edhe Planin vjetor të punës për 2020 ku kishte planifikuar dhjetë (10) auditime, prej të cilave kishte përfunduar nëntë (9). Po ashtu, në kuadër të MBPZHR operojnë edhe dy njësi të veçanta të auditimit të brendshëm, në AZHB dhe APK. NjAB në APK për vitin 2020 kishte planifikuar dhe kryer tri (3) auditime, duke realizuar planin në tërësi. Komiteti i Auditimit në përbërje prej pesë (5) anëtarëve (tre anëtarë të jashtëm dhe dy anëtar të brendshëm), gjatë vitit kishte mbajtur tri (3) takime. Auditimi ynë ka identifikuar çështjet si në vijim:

Çështja B5 - Mungesa e realizimit të planit vjetor të punës në AZHB

Gjetja	Sipas planit vjetor të punës për vitin 2020, NJAB kishte planifikuar të kryej shtatë (7) auditime. Megjithatë, gjatë vitit 2020 kishte përfunduar vetëm dy (2) prej tyre: “Pagesat Direkte për Bletë" dhe " Investimet në Asetet fizike për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore-PZHR 2018" si dhe një auditim për “Prodhimin e qumështit dhe investimet në pikat grumbulluese të qumështit” i cili ishte në formë draft. Sipas Drejtorit të NJAB, në AZHB ndër arsyet për ngecje në realizimin e planit vjetor 2020 janë mungesa e stafit auditues dhe punës me staf esencial gjatë periudhës së pandemisë.
Ndikimi	Mos realizimi i planit vjetor të punës si rezultat i mungesës së kapaciteteve njerëzore ndikon në mos identifikimin e mangësive në sistemin e kontrollit të brendshëm të AZHB-së dhe si pasojë mos ndërmarrjen e masave të nevojshme nga menaxhmenti në kohë reale për eliminim e mangësive të cilat shkaktojnë pengesa në realizimin e objektivave të AZHB-së.
Rekomandimi B5	Ministri dhe Kryeshefi Ekzekutiv i AZHB-së duhet të sigurojë që NJAB të jetë funksionale dhe me kapacitete të mjaftueshme në mënyrë që të përfundoj auditimet e planifikuara me planin vjetor të punës dhe që fushëveprimi i NJAB-së të fokusohet në vitin aktual.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final[8]	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	**62,770,521.00**	**71,794,691.26**	**69,734,309.14**	**54,938,292.54**	**52,675,811.02**
Grante Qeveritare - Buxheti	55,514,033.00	64,465,198.91	64,104,081.23	51,029,045.63	50,545,984.96
Financimi përmes huamarrjes	4,353,333.00	4,353,333.00	4,073,675.05	3,404,476.34	2,006,037.06
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	2,720,000.00	2,720,000.00	1,414,196.52	12,000.00	0.00
Të bartura nga viti i kaluar	0.00	73,004.35	72,767.52	0.00	123,789.00
Të hyrat vetanake	183,155.00	183,155.00	69,588.82	110,150.65	0.00
Te hyrat nga AKP-ja	0.00	0.00	0.00	382,619.92	0.00

Buxheti përfundimtar krahasuar me buxhetin fillestar gjatë vitit 2020 kishte pësuar shumë ndryshime. Fillimisht me rishikim të buxhetit, ishte zvogëluar për 2,422,664€, ndërsa pas rishikimi ishte rritur për vlerën 11,446,834€ nga të hyrat e bartura nga viti i kaluar, nga vendime të Qeverisë për kursime, ndarje dhe harmonizime buxheti i MBPZHR. Në total buxheti përfundimtar krahasuar me buxhetin fillestar ishte më i lartë për 9,024,170€ apo 14%.

Në vitin 2020, MBPZhR ka shpenzuar 97% të buxhetit përfundimtar ose 69,734,309€, me një përmirësim prej 3% në krahasim me vitin 2019, ku realizimi ishte 94%. Sidoqoftë, shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	**62,770,521.00**	**71,794,691.26**	**69,734,309.14**	**54,938,292.54**	**52,675,811.02**
Pagat dhe mëditjet	2,877,119.00	2,596,234.71	2,595,903.78	2,619,825.30	2,547,323.19
Mallrat dhe shërbimet	3,228,610.00	3,778,201.20	3,325,786.56	3,938,577.22	3,648,813.24
Komunalitë	157,770.00	76,968.91	61,003.28	70,327.81	78,921.25
Subvencionet dhe transferet	47,277,022.00	61,770,545.00	61,643,006.98	45,768,940.46	43,667,248.82
Investimet Kapitale	6,150,000.00	3,572,741.44	2,108,608.54	2,540,621.75	2,733,504.52
Rezervat	3,080,000.00	0.00	0.00	0.00	0.00

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar, ishte zvogëluar për 280,884€, sipas vendimit të Qeverisë Nr.09/50 të datës 21.12.2020 për harmonizimin e pagave. Buxheti ishte shpenzuar pothuajse në total;

Buxheti për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar, kishte rritje për 549,591€. Rritja ishte si rezultat i rishikimit të buxhetit në vlerë 10,642€, nga të hyrat e bartura nga viti i kaluar 73,004€, transferit nga kategoria subvencione dhe transfere në Fondin për Huamarrje (04) sipas kërkesës së projektit ARDP 536,477€. Ndërsa me vendime të qeverisë për kursime, ndarje dhe harmonizime kishte zvogëlim për 70,532€. Në këtë kategori ishin shpenzuar 88% e buxhetit;


Buxheti i shërbimeve komunale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 80,801€. Me rishikim të buxhetit ishte zvogëluar për vlerën 61,511€ ndërsa me vendime të qeverisë për 19,290€. Shpenzimi ishte 79% e buxhetit;

Buxheti për subvencione dhe transfere ishte rritur për 14,493,523€. Fillimisht me rishikim të buxhetit kishte rritje në vlerë 3,030,000€, e që pas rishikimi po ashtu ishte zvogëluar për transferin e mjeteve në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për 536,477€. Më tutje, me vendim të qeverisë në emër të programit për rimëkëmbje ekonomike kishte rritje në vlerë 12,000,000€. Shpenzimet ishin 100% e buxhetit;


Buxheti për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar, ishte zvogëluar për 2,577,259€. Me rishikim ishte zvogëluar për vlerën 2,321,794€, ndërsa me vendime të qeverisë, Nr.01/46 të datës 25.11.2020 dhe Nr.09/50 i datës 21.12.2020 ishte zvogëluar për 255,465€. Shpenzimi i buxhetit në këtë fushë ishte 59%.

Shpenzimet e ndodhura për menaxhimin e pandemisë COVID 19 nga ministria ishin 11,943,947€. Prej tyre nga subvencionet ishin 11,925,954€ dhe nga mallrat dhe shërbimet 17,993€.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Të hyrat e realizuara nga MBPZhR në 2020 ishin 2,364,281€. Totali prej 1,876,999€ apo 79% e të hyrave është realizuar nga APK kurse pjesa tjetër është nga shërbimet e ofruara nga departamentet tjera të MBPZhR-së që kanë të bëjnë me taksat drusore, qiraja, lëshimi i licencave etj.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	**2,584,954.00**	**2,150,715.00**	**2,364,280.78**	**2,328,063.82**	**2,344,181.76**
Të hyrat jo tatimore	2,584,954.00	2,150,715.00	2,235,803.38	2,324,318.57	2,326,477.10
Të hyrat tjera	0.00	0.00	128,477.40	3,745.25	17,704.66

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV të vitit 2019 për Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka rezultuar në 12 rekomandime kryesore. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit për vitin 2020, shtatë (7) rekomandime janë zbatuar dhe pesë (5) rekomandime nuk ka filluar zbatimi ende, (shih Grafikun 4). Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shih Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të sigurojnë se janë marrë masa për të ndërprerë praktikën e lidhjes së kontratave pa procedura të rekrutimit, dhe kohëzgjatja e këtyre marrëveshjeve të bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës. Në rast se ka nevojë për të punësuar shtesë në Ministri (pozita të rregullta), të sigurojnë se në buxhetin e viteve në vijim në kategorinë paga dhe mëditje të përfshihen pagat e të gjithë të punësuarve të nevojshëm, duke i procesuar përmes sistemit të pagave.	MBPZHR-APK-AZHB gjatë vitit 2020 me përfundimin e kontratave të këtyre zyrtarëve nuk ka lidhur kontrata të reja.	I zbatuar


2.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri duhet të shqyrtoj arsyet dhe nevojën për prokurimin e shërbimeve të cilat ka mund t'i kryej vet IBK-ja, si dhe të siguroj se para inicimit të çdo aktiviteti të prokurimit, merret parasysh neni 9.4 i LPP-së në mënyrë që të mos kontraktohen jashtë shërbimet të cilat mund t'i kryejnë organet/institutet që operojnë brenda vet ministrisë.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla për vitin 2020.	I zbatuar
3.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri duhet të sigurojë se me rastin e zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit, kriteret e përcaktuara nga departamenti i prokurimit duhet të jenë të qarta dhe dëshmitë e kërkuara të jenë në përputhje me kriteret e vendosura.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla për vitin 2020.	I zbatuar
4.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të siguroj që Autoriteti menaxhues harton programin me kohë me qëllim të implementimit të masave në kohën e duhur. Po ashtu, të siguroj se janë vendosur afate për pagesa direkte në pajtim me alokimet buxhetore, dhe varësisht nga disponueshmëria e fondeve buxhetore, të vendosen edhe afatet për miratimin e projekteve për grante	Edhe këtë vit ministria kishte hartuar dhe miratuar me vonesë programet për pagesa direkte dhe zhvillim rural.	Nuk ka filluar zbatimi
5.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të siguroj se të gjitha shpenzimet të regjistrohen në kodin ekonomik adekuat sipas rregullave financiare dhe udhëzimeve administrative në fuqi, në rast se asnjë nga kodet në plan kontabël nuk përputhet, atëherë duhet të kërkohet nga Thesari shtimi i një kodi të ri për paradhëniet e subvencioneve/granteve.	Kjo çështje ishte adresuar nga ana e ministrisë.	I zbatuar
6.	Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurojë se para përpilimit të dosjes së tenderit, projektet e përcaktuara të kenë specifikacionet e plota dhe të qarta të gjitha pozicioneve të punëve ndërtimore nga njësitë kërkuese në mënyrë që zbatimi i projekteve të realizohet në kohë dhe në mënyrë cilësore.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla për vitin 2020.	I zbatuar
7.	Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurojë nivelin adekuat të përgjegjësisë në zbatimin e afateve kohore të përcaktuara lidhur me njoftimin për dhënien e kontratës sipas kërkesave në Ligjin e Prokurimit Publik.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla për vitin 2020.	I zbatuar
8.	Pasuritë	Ministri duhet të ndërmarrë veprime për të siguruar regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë, siç parashihet me rregulloren Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Njëherësh të sigurojë se komisioni i inventarizimit do të bëjë krahasimin e gjendjes së pasurisë sipas raportit të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurisë dhe të reflektoj ndryshimet eventuale në PVF.	Edhe këtë vit janë përsëritë çështjet e njëjta.	Nuk ka filluar zbatimi

9.	Pasuritë	Ministri duhet të siguroj se zyrtarët përgjegjës posedojnë informatat e sakta në lidhje me regjistrin e pasurisë. Veç kësaj, për projektet e përfunduara të finalizoj procesin për bartjen e pronësisë tek komuna dhe të njëjtat t'i heq nga regjistrat.	Edhe këtë vitë janë përsëritë çështje të njëjta.	Nuk ka filluar zbatimi
10.	Llogaritë e arkëtueshme	Ministri duhet te siguroj me rastin e përgatitjes së PVF zbatohen procedurat adekuate të kontrollit të brendshëm duke verifikuar saktësinë dhe plotësinë e të dhënave për llogaritë e arkëtueshme.	Sa i përket rekomandimit të dhënë në lidhje me LL/A , MBPZHR në vitin 2020 kishte bërë prezantim të drejtë në PVF.	I zbatuar
11.	Obligimet e papaguara	Ministri duhet të siguroj se asnjë ndarje e subvencioneve dhe granteve nga ana e komisioneve përkatëse nuk do të bëhet para se fondet të jenë të sigurta dhe të gatshme për pagesë në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregullore. Problemet me alokimin e fondeve duhet të zgjidhen në bashkëpunim me Ministrinë e Financave.	MBPZHR - AZHB sa i përket subvencioneve dhe granteve vazhdon të ketë vonesa nga kërkesa për pagesë e fermerit e deri te pagesa. Çështje kjo te kategoria subvencione dhe trasnfere.	Nuk ka filluar zbatimi
12.	Auditimi i Brendshëm	Ministri/ Kryeshefi Ekzekutiv i AZHB-së duhet të sigurojë që NJAB e AZHB-së të jetë funksionale me kapacitete të mjaftueshme në mënyrë që të përfundoj auditimet e planifikuara me planin vjetor të punës dhe që fushëveprimi i NJABsë të fokusohet në vitin aktual.	Edhe këtë vit janë përsëritë çështjet e njëjta.	Nuk ka filluar zbatimi

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Baza për opinion	Ministri duhet të ndërmarrë veprime për të siguruar regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë siç parashihet me rregulloren Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në mënyrë që gjendja e pasurisë të raportohet në mënyrë të saktë dhe të drejtë.
2.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë që me rastin e përgatitjes së PFV zbatohen procedurat adekuate të kontrollit të brendshëm duke verifikuar saktësinë dhe plotësinë e të dhënave për obligimet e papaguara.
3.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë planifikimin e buxhetit në përputhje me natyrën e projekteve në mënyrë që pagesat të realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.
4.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të siguroj se respektohen të gjitha procedurat e përcaktuara me rregullore në mënyrë që para procedimit të pagesave, fillimisht të bëhet zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja, të pranohet malli/shërbimi dhe në fund të kryhet pagesa.
5.	Baza për konkluzion	Ministri duhet që me pjesën tjetër të menaxhmentit, në hollësi ta analizojë gjendjen e detyrimeve të krijuara sipas programeve të ndryshme të subvencionimit, dhe të bëj prerjen e gjendjes deri në datën e raportit. Së pari të siguroj se të gjitha grantet, pagesat direkte dhe detyrimet tjera të krijuara më herët, të paguhen, e më pas të krijon obligime të reja ndaj farmerëve.

6.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të siguroj se programi për subvencione të hartohet dhe miratohet në fillim të vitit fiskal, me qëllim të harmonizimit të tij me ciklin buxhetor, thirrjen për ndarjet vjetore të subvencioneve si dhe ekzekutimin e pagesave brenda vitit, si dhe të përcaktojë kriteret të sakta në program në mënyrë që mbështetja financiare për fermerë të jetë në përputhje me buxhetin e aprovuar vjetor.
7.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet t'i rishikoj rastet e mësipërme dhe të siguroj se financimi i fermerëve bëhet vetëm pasi të jenë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në UA. Kontrollet lidhur me ndarjen e subvencioneve duhet të jenë shumë më rigoroze.
8.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të siguroj se kriteret e përcaktuara në Udhëzim Administrativ zbatohen me përpikëri nga zyrtarët përgjegjës të AZhB-së, dhe të sigurojë se nuk do të kalojë në procesin e vlerësimit asnjë përfitues i cili nuk i ka përmbushë kushtet e kontratës paraprake.
9.	Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë se komisioni i inventarizimit do të bëjë krahasimin e gjendjes së pasurisë sipas raportit të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurisë, të azhurnoj regjistrin me rezultatet e inventarizimit dhe gjendjen e azhurnuar ta prezantoj në PVF.
10.	Llogaritë e arkëtueshme	Ministri duhet të sigurojë që dhënia në shfrytëzimin e tokave bujqësore bëhet në përputhje me kriteret e parapara me ligj, në përputhje me çmimet e tregut, si dhe duhet siguruar që të ndërmerren hapat e nevojshëm lidhur më arkëtimin e të hyrave për dhënien në shfrytëzim të tyre.
11.	Obligimet e papaguara	Ministri në bashkëpunim me Qeverinë duhet të sigurojnë fondet e nevojshme për kryerjen e obligimeve të krijuara. Po ashtu Ministri duhet të vendosë kontrollet adekuate për të siguruar se çdo vendim për mbështetje financiare do të bëhet në përputhje me buxhetin e aprovuar.
12.	Auditimi i Brendshëm	Ministri dhe Kryeshefi Ekzekutiv i AZHB-së duhet të sigurojë që NJAB të jetë funksionale dhe me kapacitete të mjaftueshme në mënyrë që të përfundoj auditimet e planifikuara me planin vjetor të punës dhe që fushëveprimi i NJAB-së të fokusohet në vitin aktual.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Qerkin Morina, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Shkelqim Xhema, Udhëheqës i Auditimit



Albesa Tolaj, Udhëheqëse e ekipit



Burbuqe Idrizi, Anëtare e ekipit



Fatlinda Podvorica, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT
Arkivi Qendror - Centralna Arhiva - Central Archive
Nr. fax/Nr.
2939
Nr. i fq./Br. Str./No. pg. 1
Data/Datum/Date: 16.07.2021
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

REPUBLIKA E KOSOVËS /REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS /VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Faton PECI

Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

Data: 16.Korrik.2021, Prishtinë

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare[9] duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.[10] . Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinioni mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)
Forma e opinionit

Opinioni i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinioni i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinioni

Opinioni i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financave;

b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose

c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin ‘theksim i çështjes’ ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç’pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

[1] Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik

[2] Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar

[3] Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

[4] Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

[5] 1.“Hartimi i planeve menaxhuese” 13,152€, 2. “Hartimi i planeve menaxhuese Lot2” faza e tretë 9,757€ dhe 3.”Sigurimi fizik i objekteve të APK-së” 3,548.88€; 1.”Pajisje për objektin e mikrovenifikimit 39,996€ dhe 2.”Konsolidimi dhe inventarizimi i tokave bujqësore” 103,710€.

[6] 1. Xhevat Uka, Sipërfaqe, vlera 30,455€; 2. Skënder Azizi Sipërfaqe, vlera 1,833€; 3. Nazim Veliu, Sipërfaqe, 1,611€; 4. Isak Kongjeli, Sipërfaqe, vlera 1,668€; 5. Haxhi Geci, Sipërfaqe, vlera 25,445€; 6. Halit Jashari, Sipërfaqe, vlera 528€;

[7] “NPTNSH Aragoniti 2” – shfrytëzimi i pronës për servisim dhe mirëmbajtje të automjeteve, auto larje, restaurant me vlerë mujore 40 ari* 20€/për ari= 800€ dhe çmimi sipas kontratës 1,200€ në muaj apo 14,400€ në vit dhe “N.SH Patroni” – shfrytëzimi i pronës për tregtim me karburnate, Çmimi sipas kontratës 25 ari * 20€/për ari = 500€ për muaj apo 6,000€ në vit.

[8] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

[9] Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit

[10] Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.